

Statistikat e kulturës*

Tremujori I – 2020

Tiranë, më 29 Prill 2020: Ky publikim përfshin të dhëna mbi numrin e shfaqjeve dhe spektatorëve në Institucionet Qendrore të Artit, të dhëna mbi numrin e vizitorëve në Institucionet e Trashëgimisë Kulturore dhe seksioni i fundit të dhëna nga Biblioteka Kombëtare.

Institucione të artit dhe kulturës

Në tremujorin e parë 2020, Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni që ka realizuar numrin më të lartë të shfaqjeve dhe premierave, me 96 të tilla, respektivisht 92 shfaqje dhe 4 premiera. Në totalin e shfaqjeve të organizuara, Teatri Kombëtar Eksperimental ka organizuar 50,5 % të shfaqjeve.

Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë është institucioni i dytë me numrin më të lartë të shfaqjeve gjithsej, me 45 të tilla, 23,7 % të shfaqjeve gjithsej.

Tab.1 Numri gjithsej i shfaqjeve/premierave në institucionet kulturore

Numri i shfaqjeve/premiera	Shfaqje		Premiera		Gjithsej	
	Tr.1-2019	Tr.1-2020	Tr.1-2019	Tr.1-2020	Tr.1-2019	Tr.1-2020
Teatri Kombëtar Popullor	56	24	1	1	57	25
Teatri Kombëtar Eksperimental	139	92	6	4	145	96
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor	25	7	10	4	35	11
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	35	44	0	1	35	45
Cirku Kombëtar	36	13	0	0	36	13
Shfaqje kulturore/premiera gjithsej	291	180	17	10	308	190

Në tremujorin e parë 2020, Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni që ka numrin më të lartë të spektatorëve, me 13.146 të tillë, 41,2 % të spektatorëve gjithsej. Ndjekur më pas nga Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor me 6.990 spektatorë, 21,9 % të spektatorëve gjithsej. Në Teatrin

* Shikoni Metodologjinë, fq. 5


Kombëtar Popullor dhe në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë pjesëmarrja është përafërsisht e ngjashme, respektivisht 16,5 % dhe 16,1 % të spektatorëve gjithsej.

Tab.2 Numri gjithsej i spektatorëve në institucionet kulturore

Numri i spektatorëve	Tr.1-2019	Tr.1-2020
Teatri Kombëtar Popullor	15.735	5.252
Teatri Kombëtar Eksperimental	22.765	13.146
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	18.950	6.990
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	3.424	5.141
Cirku Kombëtar	6.735	1.342
Numri i spektatorëve gjithsej	67.609	31.871

Numri mesatar i spektatorëve për shfaqje, në tremujorin e parë 2020 është 168 spektatorë. Pjesëmarrje më e lartë shihet në Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor.

Fig.1 Pjesëmarrja mesatare e spektatorëve për shfaqje në institucionet kulturore



Trashëgimi kulturore


Numri i vizitorëve në institucionet e trashëgimisë kulturore, në tremujorin e parë 2020 është 31.457 vizitorë, 25.917 janë vizitorë vendas dhe 5.540 janë vizitorë të huaj. Në kala e monumente të tjera, numri i vizitorëve gjithsej është më i lartë, ndjekur më pas nga parqet arkeologjike, përkatësisht 37,5 % dhe 32,7 % ndaj totalit të vizitorëve.

Në tremujorin e parë 2020, vizitorët e huaj kanë preferuar më shumë muzetë, ndjekur më pas nga kalatë e monumente të tjera, përkatësisht 45,0 % dhe 37,1 % të huaj ndaj totalit të vizitorëve.

Tab.3 Vizitorë në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike

Institucionet e trashëgimisë kulturore	Numri i vizitorëve vendas		Numri i vizitorëve të huaj		Numri i vizitorëve gjithsej	
	Tr.1-2019	Tr.1-2020	Tr.1-2019	Tr.1-2020	Tr.1-2019	Tr.1-2020
Muze	18.810	6.867	7.106	2.492	25.916	9.359
Kala e Monumente të tjera	13.511	9.746	5.007	2.054	18.518	11.800
Parqe Arkeologjike	16.148	9.304	3.733	994	19.881	10.298
Vizitorë gjithsej	48.469	25.917	15.846	5.540	64.315	31.457

Fig.2 Përqindja e vizitorëve të huaj dhe vendas në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike



Biblioteka Kombëtare

Në tremujorin e parë 2020, numri i shërbimeve të njëjësive bibliotekare është 17.213, ndërkohë numri i frekuentuesve në Bibliotekën Kombëtare ishte 26.685. Në Bibliotekën Kombëtare, në tremujorin e parë 2020 janë afishuar 1.076 tituj të rinj dhe 4.669 ekzemplarë të rinj.

Tab.4 Frekuentimi dhe botimet në Bibliotekën Kombëtare

Treguesit	Tr.1-2019	Tr.1-2020
Shërbimi i njësive bibliotekare (njësi)	19.971	17.213
Frekuentimi	30.669	26.685
Veprimtari Kulturore dhe Shkencore	35	12
Numri i hyrjeve të reja:		
Numri i titujve të rinj	1.233	1.076
Numri i ekzemplarëve të rinj	5.341	4.669

Metodologjia

*Krahasimi i tremujorit të parë 2020 me tremujorin e parë të vitit të kaluar nuk është i mundur, pasi në ndryshim nga tremujorët e tjerë ky tremujor përfshin të dhëna deri me datë 09 Mars 2020.

Aktivitetet Kulturore dhe Artistike në Institucionet Publike të Kulturës u ndërpre në bazuar në Urdhrin Nr. 140, datë 09.03.2020, me qëllim mbrojtjen e e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, sipas Urdhrit nr.132, datë 08.03.2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, *“Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”*.

Muzetë dhe Parqet Arkeologjike u mbyllën përkohësisht bazuar në Urdhrin Nr. 141, datë 11.03.2020, me qëllim mbrojtjen e e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, sipas Urdhrit nr.132, datë 08.03.2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, *“Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”*.

Të dhënat e statistikave të kulturës i referohen vetëm institucioneve qendrore të cilat janë në varësi nga Ministria e Kulturës. Në institucionet qendrore të artit e të kulturës përfshihen: Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Cirku Kombëtar.

Në totalin e muzeve, kalave dhe parqeve arkeologjike janë përfshirë institucionet:

MUZE	KALA E MONUMENTE TË TJERË	PARK ARKEOLOGJIK
Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë	Kalaja Berat	Parku Kombëtar, Butrint
Muzeu Arkeologjik, Durrës	Kalaja Gjirokastër	Parku Arkeologjik, Apoloni
Muzeu i Pavarësisë, Vlorë	Kalaja e Portopalermos	Parku Arkeologjik, Bylis
Muzeu Gjergj Kastrioti, Krujë	Kalaja e Kaninës	Parku Arkeologjik, Shkodër
Muzeu Etnografik, Krujë	Kalaja e Himarës	Parku Arkeologjik, Lezhë
Muzeu Etnografik, Berat	Amfiteatri	Parku Arkeologjik, Amantia
Muzeu Ikonografik Onufri, Berat	Manastiri i 40 Shenjtorëve	Parku Arkeologjik, Orikum
Muzeu i Artit Mesjetar, Korçë	Manastiri i Mesopotamit	Parku Arkeologjik, Finiq
Muzeu Arkeologjik, Korçë		Parku Arkeologjik, Antigonië
Muzeu Arsimit, Korçë		
Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi		
Muzeu Kombëtar i përgjimeve " Shtëpia me Gjethe"		

Përkufizime

Trashëgimi kulturore është tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individi, grupi ose shoqërie të trashëguar nga e kaluara që ruhet në të tashmen, për t'ua përçuar brezave në të ardhmen si pjesë e pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat, identitetin, njohuritë, traditat, besimet, si dhe pasuritë kulturore të peizazhit.

Muze është institucioni i ruajtjes së kujtesës, në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, që konservon, studion, komunikon dhe prezanton trashëgiminë e luajtshme e të paluajtshme të njerëzimit dhe mjedisit rrethues të tij, me qëllim edukimin, studimin, promovimin dhe argëtimin.

Monument kulture është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti.

Park arkeologjik është territori i përcaktuar me kufij të qartë, që përfshin dëshmi të rëndësishme arkeologjike të mbitorës, nëntokës e nënujit dhe bashkëprani të pasurive historike, peizazhit kulturor, i organizuar me elemente të një muzeu në natyrë.

Pjesëmarrja mesatare e spektatorëve për shfaqje llogaritet me numrin total të spektatorëve në institucionet kulturore me numrin e shfaqjeve të realizuara në këto institucione.

Bibliotekat janë institucione kulturore dhe informuese, që realizojnë hyrje të lirë në informacion në cilëndo formë që ai të jetë depozituar. Ato grumbullojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në dispozicion të përdoruesve koleksionet e veta që përmbajnë informacion në shërbim të formimit të tyre.

Frekuentimi llogaritet me numrin e shërbimeve/materialeve bibliotekare që merr çdo frekuentues i bibliotekës kombëtare.

Materiale bibliotekare përfshijnë libra, artikuj, harta, disertacione, dhe materiale audiovizuale.

Tituj të rinj përfshijnë ato materiale bibliotekare që hyjnë në bibliotekë gjatë një periudhe referuese.

Ekzemplarë të rinj përfshijnë numrin e njësisve bibliotekare për çdo titull të ri.

Burimi i të dhënave:

Të dhënat e statistikave të kulturës sigurohen nga Ministria e Kulturës, me periodicitet tremujor.